



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

*Dokument parlamentar*

**RAPORT**  
(Për dhënie mendimi)

**PËR PROJEKTLIGJIN**  
**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS**  
**SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE**  
**EKONOMISË (HUAMARRËSI), DHE AGJENCISË FRANCEZE PËR ZHVILLIM,**  
**PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “POLITIKA PËR MBËSHTETJEN E REFORMËS**  
**NË SEKTORIN ENERGETIK NË SHQIPËRI”**

➤ **HYRJE**

Më 19 janar 2022, Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim (huadhënësi), për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm

- Z. Ilir Bejtja, Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
- Z. Enea Karakaçi, Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Znj. Kesjana Halili - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj
- Znj. Elona Mistrovica - Drejtor i Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj

**I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, si dhe me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

**II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT**

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe Agjencisë

Franceze për Zhvillim (huadhënësi), për financimin e projektit “Politika për mbështetjen e reformës në sektorin energjetik në Shqipëri”, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës së Francës i jep mundësi Republikës së Shqipërisë marrjen e një huaje me kushte të favorshme nga Agjencia Franceze për Zhvillim (në vijim, AFD), për programin “Mbështetja e reformës së sektorit energjetik të Shqipërisë”, në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro.

### **III. EFEKTET FINANCIARE**

Sa i takon efekteve financiare, sqarojmë se huaja nga Agjencia Franceze për Zhvillim (në vijim, AFD), për programin “Mbështetja e reformës së sektorit energjetik të Shqipërisë”, në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro ka termat financiarë të mëposhtëm:

Shuma:	50,000,000 euro;
Interesi:	euribor 6-mujor + 1.35%;
Komision angazhimi:	0,25 % në vit;
Afati i ripagimit:	12 vjet;
Periudhë pa pagesë principali:	3 vjet;
Tarifë menaxhimi:	0.75%

Zbatimi i këtij projekti në këtë fazë nuk do të ketë efekt financiar shtesë në buxhetin e shtetit

### **IV. DISKUTIMET NË KOMISION**

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, pasi theksoi se Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, ia dha fjalën znj. Kesjana Halili, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj.

Znj. Halili bëri prezantimin e detajuar të projektligjit duke theksuar, midis të tjerave, projektligji është vazhdimi i angazhimit të qeverisë shqiptare për të finalizuar reformimin e të gjithë sektorit të energjisë elektrike në Shqipëri, duke plotësuar angazhimin ndërkombëtar të tyre lidhur me këtë reformim, i cili do të përfshijë, ndër të tjera, konsolidimin e ndarjes së OSHEE-së – Furnizuesit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, funksionimin e Bursës së Energjisë (APEX) dhe hapjen graduale të tregut të shitjes me pakicë, së bashku me krijimin e një tregu konkurrues të energjisë.

Z. Ilir Bejtja, Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, gjithashtu dha shpjegime përsa i përket nismes në përmbushje të planit strategjik i cili përmban një sërë masash reformuese, me qëllim krijimin e një tregu të organizuar, sipas modelit të Bashkimit Evropian, që bazohet në çmime konkurruese dhe udhëhiqet nga parimet e të qenit transparent, jodiskriminues dhe i qëndrueshëm.

Z. Benet Beci, në cilësinë e relatorit, vlerësoi rëndësinë e nismës për zhvillimin e burimeve kombëtare të energjisë, që çon në një sistem rajonal të integruar e të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale.

Më tej anëtarët e Komisionit bënë pyetje dhe komente lidhur me situatën energjitike në vend, masat e Qeverisë për lehtësimin e barrës së krizës për qytetaret dhe impaktin e marrëveshjes në fjalë.

Në sqarimet e tij tepër të detajuara, z. Bejtja, Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë sqaroi, midis të tjerave, përpjekjet që konsumatorët e energjisë me tension të ulët, që janë qytetarët dhe bizneset e vogla, të mos kenë një rritje të pagesave.

Znj. Mimi Kodheli, në përfundim të diskutimeve, shprehu mbështetjen e saj të plotë ndaj nismës dhe ftoi Komisionin për të votuar projektligjin.

#### ➤ **PËRFUNDIME**

**Në aspektin ligjor**, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

**Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

**Në përfundim**, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe pasi e miratoi atë u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

**RELATOR**

**KRYETARE**

**Benet BECI**

**Mimi KODHELI**